

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komuna e Podujevës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **615-25-877-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **“Shenjëzimet Horizontale dhe Vertikale”**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“TSR” Sh.P.K.

Rr. “Fehmi Lladrovci” nr. 99

Fushë Kosovë

12000

+383 (0)44 34 13 68

Marksim Malsijaj, Drejtor

info@tsr-ks.com

08.05.2025



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftimi për Kontratë & Dosja e Tenderit – 14.02.2025
B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK – 24.04.2025
Kërkesa për rishqyrtim – 28.04.2025
Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim – 02.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim – 28.04.2025
Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim – 02.05.2025

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 59 par. 4 i LPP

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues (tutje si “AK”) me datë 24.04.2025 ka publikuar njoftimin mbi vendimin përmes të cilit ka rekomanduar për kontratë GOE “Lindi Markings shpk & Rinovo shpk” ndërsa ofertën tonë “GOE TSR shpk & IDK Konstruktion shpk” e ka eliminuar si të papërgjegjshme. Me këtë rast AK ka shkelur në mënyrë flagrante nenin 59 par. 4 et. al. të LPP për arsye se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar ofertë tërësisht të papërgjegjshme për çka duhet eliminuar si i papërgjegjshëm dhe jo të shpërblehet me kontratë. Në anën tjetër oferta jonë është oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë dhe të gjitha arsyet eliminuese janë tërësisht të gabuara dhe absolutisht të pavërteta.

GOE i rekomanduar për kontratë “Lindi Markings shpk & Rinovo shpk” kanë dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Kjo për arsye se të njëjtit kanë prezantuar një autorizim nga TECOL NPSH kinse si distributor i autorizuar nga prodhuesi slloven KANSAI HELIOS SLOVENIJA d.o.o. Ky autorizim është i kundërligjshëm dhe/apo i falsifikuar pasi që ne kemi siguruar nga prodhuesi “KANSAI HELIOS SLOVENIJA” deklaratën ku thuhet se as TECOL NPSH dhe as LINDI MARKINGS SHPK nuk janë dhe nuk mund të përfaqësojnë prodhuesin KANSAI HELIOS SLOVENIJA d.o.o. në Republikën e Kosovës. Deklarata është dërguar drejtpërdrejtë nga prodhuesi (shih figurën vijuese):

www.kansai-helios.si



KANSAI HELIOS Slovenija d.o.o.
KANSAI HELIOS Slovenia Ltd
Količevo 65 • 1230 Domžale, Slovenija

Domžale, 28.4.2025

Clarification of facts about KANSAI HELIOS SLOVENIJA sales agreements in Kosovo

Dear Sirs Madam, to whom it may concern.

The Letter of Authorization document from 2019 says that the TECOL NPSH represent KANSAI HELIOS SLOVENIJA d.o.o. (old name: HELIOS TBLUS d.o.o.) in business on the market of Republic of Kosovo through the sale of our products.

The fact is that since 2020, TECOL NPSH has only done business with KANSAI HELIOS SLOVENIJA d.o.o. in smaller transactions, which only related to materials for their construction projects. The document issued in 2019 was of an operational nature and does not stipulate an agreement. The document is currently under internal control.

It is also a fact that KANSAI HELIOS SLOVENIJA d.o.o. has one and only a valid and operational sales contract with the company AgroCom shpk, through which road marking materials are being sold on market of Kosovo continuously for several past years.

All these facts show that the aforementioned document from 2019 is not functional and cannot be used as a basis for TECOL NPSH or Lindi Markings sh.p.k. to be the representative of KANSAI HELIOS SLOVENIJA d.o.o. for the sale of road marking materials in the Republic of Kosovo.

Document prepared by:

Sonja Osojnik
Area Sales Manager for Road markings

In authorisation of
Tomaž Kumer
Director of program Road Markings, Helios TBLUS



74

KANSAI HELIOS Slovenija d.o.o. / KANSAI HELIOS Slovenia Ltd.
Količevo 65, 1230 Domžale, Slovenija
T +386 1 722 40 00 • F +386 1 722 43 10 • office@kansai-helios.si

Part of KANSAI
HELIOS

Vpis v sodni register: Okrožno sodišče v Ljubljani, št. reg. vl.: 10447300 • Osnovni kapital: 15.118.275,00 EUR • Matična št. 50432120000 •
ID za DDV: SI45984794
Entry in the Ljubljana Court Register, Entry No.: 10447300 • Share capital: 15.118.275,00 EUR • registration numb. 50432120000 •
Tax No.: VAT SI45984794

Në vendimin e AK për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, thuhet se dokumenti si në figurën më sipër nuk është kërkuar të prezantohet duke injoruar në tërësi të gjeturat sipas të cilave AK është tentuar të mashtrohet dhe të dëmtohet buxheti i AK. Për më tepër edhe në kërkesat sipas ST – aneksi 1 në DT, vet AK ka përcaktuar vërejtjen si vijon:

Qëllimi i Kontratës	2.1	Qëllimi i kontratës është që të përcaktohen kushtet që rregullojnë kryerjen e shërbimeve në vijim: <i>Shëno përshkrimin e përgjithshëm të shërbimeve dhe sasi të vlerësuara të cilat MUND të blehen gjatë kohëzgjatjes së kontratës publike kornizë:</i> Shenjëzimet Horizontale dhe Vertikale Për sasi dhe detaje tjera referojuni specifikacionit
---------------------	-----	--

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Vërejtje: “Operatori ekonomik që konkurron është i obliguar të dëshmojë me dokumentacion se produktet e ofertuara janë të barasvlefshme dhe ekuivalente me kërkesat e vendosura në specifikimin teknik në dosje të tenderit duke i bashkangjitur, katalogje, prospekte me përshkrime teknike, mostrat, certifikata sipas përshkrimeve teknike për materialet e kërkuara”.

Vlen të ceket se ka OE edhe katalogët e prodhuesve tjerë si p.sh. “Helios” dhe “3M” i shfrytëzon pa autorizimin e tyre (që përbën shkelje tjetër të LPP). Kjo konfirmohet me faktin që nuk ka fare autorizim nga 3M për RKS (kjo pasi që prodhuesi 3M fare nuk ka distributor të autorizuar në Kosovë por vetëm në Serbi, ndërsa në RKS ka vetëm blerës por jo edhe distributor). Kësisoj AK duhet të ketë parasysh se autorizimi dhe katalogët me dokumentet përcjellëse të tyre në emër të këtij prodhuesi janë të pavlefshme përkatësisht të manipuluar sikurse janë të manipuluar edhe dokumentet e prodhuesit Helios nga ky OE.

Përderisa AK i konteston mostrat tona pikërisht duke u bazuar në këtë kërkesë të DT, standardi i njëjtë nuk është zbatuar edhe për tenderuesin e rekomanduar që nënkupton se AK e ka favorizuar tenderuesin e rekomanduar ndërsa e ka diskriminuar në mënyrë flagrante ofertën tonë.

AK në letrën standarde për eliminimin tonë pretendon që nuk kemi përmbushur kërkesën e DT lidhur me menaxherin e projektit përkundër faktit që ne kemi dorëzuar në ofertën tonë të gjitha dëshmitë dokumentare të përcaktuara me DT lidhur me këtë kërkesë. Në anën tjetër lidhur me kërkesën e njëjtë të DT, AK e pranon si të mjaftueshme vetëm një deklaratë të tenderuesit të rekomanduar në folderin nr. 2 të ofertës së tij. Pra AK e pranon si të vlefshme këtë deklaratë ku thuhet se menaxheri i projektit do të jetë z. Hekuran Osmanaj, edhe pse mungojnë dëshmitë tjera sipas kërkesës së DT siç janë kopja e diplomës dhe CV. Duke marrë parasysh faktin që këto dokumente nuk janë dorëzuar, atëherë tenderuesi i rekomanduar nuk e ka përmbushur as këtë kërkesë të DT dhe nuk është ofertues i përgjegjshëm (duhet eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë).

Sa i përket kërkesës nr. 3 në DT – kapaciteti teknik dhe profesional, sërish AK mjaftohet vetëm me një deklaratë të tenderuesit të rekomanduar pa dorëzuar fare dëshmitë tjera dokumentare. Në DT lidhur me teknikun e komunikacionit duhet të prezantohet kopja e diplomës, CV, kontrata ose parakontrata për angazhim. Tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar vetëm një deklaratë ku e prezanton z. Fatmir Gjekaj si teknik të komunikacionit mirëpo nuk e bashkangjiti as diplomën, CV dhe as dëshmitë tjera që kërkohen nga AK. Pra edhe në këtë pikë tenderuesi i rekomanduar është absolutisht i papërgjegjshëm.

Te kërkesa nr. 4 e DT lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, kërkohet që OE të prezantojë pajisjet teknike sipas aneksit 7 të DT (*Kërkesa 4: për pajisjet teknike të aplikuara në aneksin 7 të prezantohen Dokumentet Unike Doganore, Librezat e qarkullimit Rrugor me*

validitet apo faturat e shitblerjes së paisjeve). Sërish AK edhe për këtë kërkesë të DT e favorizon tenderuesin e rekomanduar ashtu që pa prezantuar fare dëshmitë dokumentare të kërkuara me DT, mjaftohet vetëm me disa fotografi të prezantuara nga tenderuesi i rekomanduar. AK nuk e merr mundin fare që t'i verifikoj faturat edhe pse shumica prej tyre janë vetëm disa profatura (profatura dhe fatura kanë dallim substancial juridik) të cilat nuk dihet fare nëse janë paguar dhe regjistruar sipas legjislacionit në fuqi. Profaturat për të cilat po bëhet fjalë janë si vijon:



4-Paisje digjitale
per matjen e asfaltit



5-Makina per pahi
elastike.pdf



7.2-Ploteri dhe
makina per prerje.pdf



7-Fatua e kateriit JC
135.pdf



8-Valaku per
ngjeshjen e Folies d



11-Fatura e
makineris Shpojse



13-Fshes per
Gfshirjen e rruges.pdf

Duke ditur faktin se të gjitha këto produkte janë importuar nga vendet e ndryshme, lind pyetja pse nuk është bashkangjitur edhe dudi doganor. Pra jo vetëm që nuk është dorëzuar fatura (por vetëm profatura) mirëpo nuk është bashkangjitur as dudi doganor si p.sh. Poz 7.1 dëshminë e pagesës:



7.1-kateri.pdf

Duhet theksuar edhe çmimet e prezantuara nga tenderuesi i rekomanduar në profatura lidhur me këto produkte janë çmime absolutisht qesharake. Pra shumë sinqerisht dyshimet e këtyre faturave janë me të vërtetë dyshime të bazuara dhe sipas të gjitha gjasave ato janë dokumente manipulative prandaj AK nuk duhet të pranoj profatura në vend të faturave kur në DT shprehimisht thuhet se OE duhet të dorëzoj fatura dhe jo profatura.

Te kërkesa nr. 3 në DT – kapaciteti teknik dhe profesional kërkohet që OE të prezantoj leje për ushtrimin e veprimtarive të prodhimit të konstruksioneve metalike dhe sinjalistikës rrugore. Paradoksalisht, në letrën standarde për eliminimin tonë pretendon se oferta jonë nuk e plotëson pikërisht këtë kërkesë. Për këtë pikë do të prezantojmë kundër-argumentet në vijim, megjithëse ne kemi prezantuar lejin e veprimtarisë nga agjencia përkatëse (që e posedon partneri ynë i GOE). Në anën tjetër për tenderuesin e rekomanduar AK sërish përdor standarde favorizuese pasi që AK e pranon si të mirëqenë dokumenti si në vijim:




8-Vendimi i
Veprimtaris LM.pdf

Vendimi në fjalë që AK e merr si të mirëqenë, në realitet është një leje për objektin që i plotëson kushtet sanitare higjienike për këtë veprimtari, mirëpo nuk është leje për ushtrimin e kësaj veprimtarie. Përndryshe një leje e tillë për ushtrimin e veprimtarive ekonomike lëshohet vetëm nga ARBK qoftë në RKS apo në shtetet tjera përkatëse. Pra është shumë e çuditshme se si AK e pranon këtë dokument si të mirëqenë pavarësisht që as për së afërmi nuk e përmbush kërkesën përkatëse të DT.

AK në DT në kuadër të specifikave teknike ka kërkuar që të prezantohen edhe mostrat sipas figurave përkatëse. Mirëpo tenderuesi i rekomanduar nuk e ka dorëzuar mostrën sipas dimensioneve të kërkuara me DT/ST (0.4x0.4x0.4cm) por as sipas figurës me nr. 10 ku me dimensione 500x500x500mm.

Ja si ka qenë kërkesa e dosjes së tenderit:

Furizimi dhe vendosja e pengesave nga betoni i parafabrikuar me dimensione 0.4x0.4x0.4cm, duhet te sjellet mostra se bashku me ofertë, pengesat planifikohen te vendosen ne organizimin e rrugeve gjate sezonit veror dhe dimeror.



Tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar një mostër me dimensione dukshëm më të vogla sesa ato që janë kërkuar me vizatimin teknik nga DT sipas figurës më sipër, ndërsa me dimensione më të mëdha nga ato që janë përcaktuar në tekstin më sipër. Me pak fjalë mostra e tenderuesit të rekomanduar nuk përkon me dimensionet e kërkuara sipas DT, prandaj duhet të eliminohet si ofertues i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Në vendimin e AK për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, AK na akuzon kinse për çmime jonormalisht të larta. Natyrisht se një pretendim i tillë është po ashtu i pabazuar për të mos thënë edhe tendencioz dhe diskriminues. Fillimisht ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar përmes poentimit të çmimit. AK pretendimin e vet mundohet t'a arsyetoj duke e marrë çmimin më të lartë të poentuar sipas paramasës dhe nuk tenton fare që të konfirmoj këtë çmim sipas realitetit në terren dhe në tregun aktual. Si fillim duhet sqaruar se është fakt i pakontestueshëm që rreth 70% e buxhetit të parashikuar për këtë tender parimisht dedikohet për shenjëzimin horizontal apo për grupin II – 55%. Duke parë se çmimet e tenderuesit të rekomanduar në paramasën e tij, rezulton se në fakt tenderuesi i rekomanduar ka abuzuar me çmime jonormalisht të larta me qëllimin që të ekzekutoj sa më pak punë me buxhetin e njëjtë. Rrjedhimisht në pozicionin për të cilin po bëhet fjalë, tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmimin 186,95 euro ndërsa ne kemi ofertuar me çmimin e poentuar prej 82.50 euro. Ndërsa pothuajse në të gjitha pozicionet tjera, tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta të cilat fare nuk përputhen me çmimet e tregut dhe nuk mund të mbulojnë as produktet dhe lëre më shpenzime tjera apo marzhën e fitimit. AK nuk ka kërkuar fare sqarime për këto pozicione sipas nenit 41 të RRPP. Pra tenderuesi i rekomanduar ka abuzuar me çmime dhe jo ne.

Pretendimet sipas të cilave arsyet eliminuese të ofertës tonë janë të pasakta.

Nuk qëndron arsyeja e parë eliminuese e formuluar si vijon:

Ju si OE, para ofertimit ne AK- Komuna Podujeve, keni prezantuar mostrat ne te cilat keni vene shenja dalluese gjeesisht keni pershkruar emrin e kompanise dhe ky veprim bie ndesh me nenin 37, par 3 dhe 4 te Rregullores

Fillimisht duhet sqaruar se me rastin e dorëzimit të mostrave në objektin e AK nuk ka qenë prezent asnjë përfaqësues i sektorit të prokurimit. Në mostrat tona nuk është dorëzuar asnjë shenjë identifikuese por vetëm shenjat e domosdoshme për AK që të kuptohet se cila mostër

nga cili OE po dorëzohet (në të kundërtën mostrat mund të ndërrohen, ndryshohen apo ngatërrohen qoftë me ose pa qëllim). Përndryshe mostrat si të tilla i përmbushin të gjitha kërkesat e përcaktuara me DT (ky fakt nuk kontestohet as nga vet AK). Po të kishte qenë një përfaqësues i sektorit të prokurimit nga AK në ditën e dorëzimit të mostrave, ne kemi qenë të hapur që të pranojmë edhe instruksione të caktuara për mënyrën e dorëzimit të mostrave. Mirëpo prezent nuk ka qenë asnjë përfaqësues i prokurimit dhe jo vetëm që nuk është dhënë asnjë instruksion lidhur me dorëzimin e mostrave, por nuk është mbajtur as evidenca në mënyrë të rregullt që krijon shumë hapësirë për manipulim me mostra. Prandaj ky arsyetim eliminues është totalisht i pasaktë për të mos dhënë mjaft i pakuptimtë si tentim i komisionit vlerësues për të dëmtuar kompanitë tona në këtë procedurë të prokurimit.

Përpos kësaj dhe duke u mbështetur çdo here në Rregulloren RRPP-001/2022 të përditësuar shihet se askund nuk cekët dhe nuk tregohet se si duhet dorëzohen mostrat. Me vet faktin që rregullorja në fjalë e thotë se AK duhet të caktoj një zyrtar i cili do të largoj shenjat identifikuese të mostrave, dhe askund nuk e tregon se si duhet dorëzohen mostrat, vetëkuptohet se mostrat duhet dorëzohen me të dhëna përndryshe ato ngatërrohen me mostrat tjera të OE. Ja si e përshkruan neni 37 i RRPP-001/2022 i përditësuar këtë detyrim të AK-së:

37.3 Mostrat e dorëzuara nga OE si kusht duhet të inspektohen nga një komision.

37.4 Në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet t'i:

- a. eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE; dhe
- b. shënohen nga një kod.

37.5 Personi që eliminon shenjat nga mostrat dhe që vendosë kodet nuk do të merr pjesë në procesin e vlerësimit dhe nuk do të bëjë të ditur identifikimin e mostrave për anëtarët e komisionit të vlerësimit.

Pra sipas kësaj që po e thotë rregullorja, arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë me konstatimin se kemi dorëzuar mostra me shenja dalluese të kompanisë, është plotësisht jo ligjor dhe plotësisht i gabuar.

Nuk qëndron arsyeja e dytë eliminuese e formuluar si vijon:

Ju si OE ne oferte ne cilesi te stafit keni prezantuar me z. Bekim Ahmeti, Xhemil Halili dhe Naim Kadriu. Komisioni vleresues i ofertave pergjate vleresimit percaktimit dhe krahasimit te ofertave ka konstatuar se te njejtat realizojne page nga thesari i Kosovës te deklaruar me pune primare dhe nga ju si OE. Ky fakt konfirmohet sipas verifikimit online ne ATK (rubrika e deklarimit te tatimpaguesit) Komisioni vleresues i ofertave te AK - Komuna Podujeve me qellim te vleresimit, ekzaminimit dhe krahasimit te ofertave ka ardhë ne perfundim se deklarimi i dyfisht me pune primare paraget shkelje ligjore si rjedhoje ATK, ne ueb fagen e saje ka te publikuar opinionin ligjore si me poshte: "Per qellime te llogaritjes së obligimit tatimor të tatimit te mbajtur ne burim ne paga, nje i punësuar, brenda nje periudhe tatimore mund te ketë vetëm një punedhënes primar. Meqenëse, per aq sa është kuptuar pytja juaj, në rastin tuaj, brenda nje periudhe tatimore mund t'i keni dy burime të të hyrave, nga dy punedhënes të ndryshëm, duhet te percaktoni se cili është punedhënes primar, për të cilën duhet t'i njoftoni punedhënesit te tjerë si punedhënes sekondar. Gjithashtu, për aq sa keni uje punedhënes primar, pavarësisht pagesës, punedhënesi tjetër konsiderohet punedhënes sekondar. Me raport. ATK26160/2022» Ne kontratat e prezantuara ne oferte per stafin tuaj, ne nenin 2, dhe dispozitat tjera percaktohet orari i punes dhe atë per periudhe kohore prej 40 oreve ne jave apo 8 ore ne dite. (per këte komisioni i vlerësimit te ofertave rezervon te drejten per sqarime/ raportim te metutjeshem ne Administraten Tatimore te Kosovës ashtu siç percaktohet me nenin 59 dhe 72 te L.PP-se)

Si fillim punonjësit Xhemil Halili dhe Naim Kadriu janë pjesë e stafit tonë mirëpo të njëjtit në këtë tender janë prezantuar si staf shtesë (pra përtej kërkesave që janë përcaktuar me DT). Rrjedhimisht nuk është fare relevant konstatimi i AK në raport me këta dy punonjës. Mirëpo për të sqaruar situatën, ju njoftojmë që këta Naim Kadriu p por edhe inxhinieri ynë Bekim Ahmeti, që të dyt janë punonjës të rregullt në kompaninë tonë në marrëdhënie primare të punës. Ata kur kanë aplikuar për punë kanë aplikuar për punë primare me orar të plotë 40 orë në javë. Si të tillë e kanë lidhur edhe kontratën e punës dhe natyrisht që si të tillë edhe

janë deklaruar në ATK. Nëse të njëjtit kanë marrëdhënie tjetër të punës, ajo padyshim që është marrëdhënie dytësore e punës pasi që ata punojnë secili nga 40 orë në javë. Pra punëdhënësi i dytë kushdo qoftë ai, ka për detyrim që t'i deklaroj punonjësit me marrëdhënie sekondare të punës. Nëse eventualisht nuk është vepruar në këtë mënyrë, ne nuk mund dhe nuk duhet të sanksionohemi nga AK për shkak të veprimeve apo mosveprimeve nga institucionet apo kompanitë tjera. Për të konfirmuar këtë gjendje faktike ju lutem referojuni kontratave të punës për personat në fjalë dhe sidomos për inxh. Bekim Ahmeti dhe Naim Kadritu pasi që ne ketu ja bashkangjism edhe deshmin e pagesave dhe deshmin e pagave mujore , dhe siq shifet me nje pag te till nuk mund te jen vetem ne meny figurative po esht indiator i qart se punojn me orar 40 or ne jav , mirpo kan edhe leje nga ne te ushtrojn edhe veprimtari te dyt , ndersa sa i perket inxhinjerit tjetër (Xhemil Halili) staf shitesë dhe nuk janë kërkuar me DT. Kësisoj është gjetur se edhe ky arsyetim eliminues është totalisht i pasaktë dhe i pabazuar. Perkundrazi ketu esht dashut qe me teper te shikohet OE i shpallur fitues se a i plotson keto kerkesa e jo ne si nje OE I cili vepron me shum sukses ne shum komuna te kososves me ket veprimtari (Deshmija 12 Lista e pagave muj 12 2024 e stafit dhe e pagave per Inxhinjeret e lartcekur)e njejta pages esht edhe mujt tjer mund te kontrollohet ne gjdo koh nga AK

Nuk qëndron arsyeja e tretë eliminuese e formuluar si vijon:

3. Ju si grup i OE ne oferte nuk keni prezantuar vendmin apo licence për prodhimin dhe sinjalistike rrugore ashtu siq është kerkuar ne dosje te tendeit, ne piken 9.1& 9.2te FDT-se.

Ky arsyetim eliminues nuk qëndron pasi që licensa në fjalë është prezantuar nga anëtari i GOE “IDK Konstruktion” (shih folderin nr. 7 fq. 10 të ofertës) e cila duket si vijon:



GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIIS)	K51408016J
2. Data e Regjistrimit	05/07/2004
3. Emri i Subjektit	I.D.K-KONSTRUKSION
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	28/06/2004
6. Kohëzgjatja	Nga: 28/06/2004
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Vore VORE Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Rruga Zaja, Koder Bexulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167
8. Kapitali	355.000.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Sinjalistike rrugore vertikale, horizontale, siguri rrugore, ndricuese dhe jondricuese, studim,projektim, prodhim,montim, tregtim dhe zbatim te tyre. Import-eksport, tregti me shumicedhe pakice te sinjalistikës rrugore, targa prokate, metale per skrap, veshjeve te punes, paisje dhe veshje per parandalimin e aksidenteve, per sigurimin teknik ne pune, vegla pune tepajisjeve dhe pjesese industriale, telekomunikacioni, pajisje elektrike, panele diellore.etj.Tregtim artikujsh te ndryshem industriale. Tregtim automjetesh te cdo lloji, marke e tonazhisi dhe pjese kembimi per to. Import, eksport dhe shitje me shumice dhe pakice te pjesese te kembimit per autoveturat dhe automjetet e te gjitha llojeve dhe tipeve te ndryshme duke perfshire ketu dhe makina te cdo lloji dhe tonazhi. Shitje pjese kembimi, goma te ndryshme, bateri automjetesh. Importimin dhe

Vlen të shtohet se edhe anëtari tjetër i GOE “TSR” në kodet e veprimtarisë të regjistruara në RKS/ARBK e ka të përcaktuar edhe kodin 2511 – prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre.

Nuk qëndron arsyeja e katërt eliminuese e formuluar si vijon:

4. Ne aneksin 7 te dosjes se tenderit ne pozicionin 6 eshtë kerkuar: "Gjyesem rimorkio me sinjalizim te punimeve ne rruge". Juve si Grupi i OE-ve ne oferte keni prezantuar rimorkio me sinjalistike.

Pajisja që ne e kemi prezantuar është gjysmërimorkio saktësisht sikurse është kërkuar me DT. Natyrisht që ne nuk marrim përgjegjësi për mënyrën se si emërtohet pajisja në Gjermani ku e kemi blerë pajisjen (pasi që në Gjermani nuk ekziston termi gjysmërimorkio), mirëpo pajisja në fjalë duket si në fotot vijuese. Komisioni vlerësues ka pasur mundësi që të del në terren dhe të konstatoj se cila është pajisja në fjalë si dhe të konfirmoj që e njëjta ndodhet në pronësinë dhe posedimin tonë. Pra edhe kjo arsye e eliminuese është totalisht e pabazuar. Sa për ilustrim ne qoft se shifet në foto pikerisht me një konstrukcion të tillë e ka edhe OE i shpallur fitues rimorkion andaj na qudit fakti i standarteve të dyfishta



Nuk qëndron arsyeja e pestë eliminuese e formuluar si vijon:

5. Ju si OE ne oferte nuk keni prezantuar, vendim mbi caktimin e menaxherit të projektit ashtu sic është kërkuar në pikën 9.1 & 9.2 të FDT-se, prandaj oferta juaj është e pa përgjegjeshme.

Vendimi për menaxher të projektit ndodhet në ofertën tonë shih folderin nr. 2 fq. 8 dhe duket si vijon:

Ne bazë të Ligjit të punës në Kosovë ,njehkosisht duke ju referuar DT për tenderin tenderuar nga Autoriteti; KOMUNA E PODUJEVËS;Titulli; Shenjzimet Horizontale dhe Vertikale Nr i Prokurimit; 615-25-877-2-1-1,Une Marksim Malsijaj në cilsin e autorizuesit të Konkercjunit Emroj Zotri Bekim Ahmeti si Menaxher i projektit të lartpermendur sipas kërkesës së AK, z.Ahmeti ne qoft se koncercjumi yn do të jet fitues për ekzekutimin keti projekti do të ket autorizimin qe te filloj eksekutimin e projektit të lartpermendur ne cilsin e menaxherit të projektit ,ndersa ne cilsin e Udhëheqesit të Punishtes emrojm Zotri Naim Kadriu, , (Ndersa Ndhimes Menaxheri Rezerv apo ndihmes udheheqes punishteje rezerv emrojm z.Xhemil Halili dhe Besart Osmeni)

TSR Shpk

I autorizuari i Konkercjunit



Nga sa u tha më sipër propozojmë që pas shqyrtimit të kësaj ankese, paneli shqyrtues të merr këtë:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “TSR” Sh.P.K. ashtu që **DETYROHET** AK që aktivitetin e prokurimit t’a kthej në **RIVLERËSIM**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do caktohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*